

VENDIM
Nr. 117, datë 16.3.2000

**PËR MIRATIMIN E PROJEKTIT “NDËRTIMI I KAPACITETEVE KOMBËTARE PËR
INSTITUTIN E SIGURIMEVE SHOQËRORE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të vendimit nr.116, datë 24.2.1997, të Këshillit të Ministrave, “Për kompetencat, procedurat, nënshkrimin, lëvrimin, regjistrimin, zbatimin, shlyerjen dhe raportimin e huave dhe ndihmave të huaja, që i jepen qeverisë së Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Punëve dhe Çështjeve Sociale dhe të ministrit të Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e projektit “Ndërtimi i kapaciteteve kombëtare për Institutin e Sigurimeve Shoqërore”, të financuar me shumën 400 400 (katërqind mijë e katërqind) USD, nga të cilat 350 400 (treqindpesëdhjetë mijë e katërqind) USD do të financohen nga Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (PNUD).

2. Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale ngarkohet institucion përgjegjës për monitorimin e zbatimit të këtij projekti, në përputhje me objektivat e parashikuara në projekt.

3. Ngarkohet Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e projektit dhe për përballimin e shumës prej 6 700 000 (gjashtëmilionë e shtatëqind mijë) lekësh (ekuivalent i 50 000 (pesëdhjetë mijë) USD-ve, si kosto vendore, e parashikuar në projekt.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta